REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË ISTOG
OSNOVNI SUD PEC - OGRANAK ISTOK BASIC COURT OF PEJA-BRANCH IN ISTOG

P.nr. 356/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PEJE-DEGA ISTOG – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Arben Mustafaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike, Hale Ahmetaj, në lëndën penale kundër të pandehurve S K dhe M K, qe të dy nga R Republika e Malit te Zi, të akuzuar si bashkëkryerës për vepër penale, "lëndim i lehtë trupor" nga neni 185 par.1, nën par.1.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II/nr.3114/19, dt. 27.12.2019, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.**31.12.2019,** në praninë e Prokurorit të Shtetit, Ersan Qavolli, të pandehurit S K me mbrojtësin e tij av.Zeqir Bujupaj nga Istogu, dhe i pandehuri M K me mbrojtësen e tij av. Pranvera Ukaj, nga Istogu, Gjykata të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më dt.06.01.2020 e përpilojë këtë:

A K T GJ Y K I M

1.I pandehuri **S K,** i lindur me ... ne R Republika e Malit te zi, ku dhe banon rr." C ..." i biri i M dhe nenës A, e gjinisë SH, i martuar, babai i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion sipërmarrës, i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar ne bazë të letërnjoftimit te Republikës se Malit te Zi me numër personal ..., i nacionalitetit Boshnjak- Musliman, Shtetas i Republikës se Malit te zi, ka qëndruar në paraburgim nga dt.21.12.2019, deri me dt.31.12.2019, sipas Aktvendimit me PP nr.148/19 i dt.23.12.2019, i pa dënuar me parë nga Gjykata, tani gjendet në liri.

2.I pandehuri **M K,** i lindur me .... ne R ku dhe banon rr. " ..." Republika e Malit te Zi , i biri i Ss dhe nenës M, e gjinisë M, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar ne bazë të letërnjoftimit te Republikës se Malit te Zi me numër personal ..., i nacionalitetit Boshnjak , Shtetas i Republikës se Malit te zi, ka qëndruar në paraburgim nga dt.21.12.2019, deri me dt.31.12.2019, sipas Aktvendimit me PP nr.148/19 i dt.23.12.2019, i pa dënuar me parë nga Gjykata, tani gjendet në liri.

JANË FAJTOR
Për shkak se:

Me dt.21.12.2019, rreth orës 14,2o, ne fsh. D K. I, me dashje dhe ne bashkëveprim u shkaktojnë lëndim te lehta trupore të dëmtuarve F K dhe M S nga fsh. D K. Istog, ne atë mënyrë që dy të pandehurit kishin ardhur nga Republika e Malit te Zi për te biseduar rreth një çështje familjare (ku vajza e të pandehurit S kishte qenë e martuar me djalin e te dëmtuarit F dhe e njëjta kishte marrë fëmijen 9 muajsh dhe ishte larguar ne Malin e Zi) dhe sapo të pandehurit arrijnë ne oborrin e te dëmtuarit F menjëherë fillon një fjalosje mes tyre, e më pas të dy te pandehurit godasin të dëmtuarit F dhe M, duke ju shkaktuar lëndim te lehta trupore, përshkruara si ne raportin mjekësorë të dt.21.12.2019 e ku ndërhyjnë dëshmitaret dhe i ndajnë.

- me çka në bashkëveprim kanë kryer vepër penale lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.1, nën par.1.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

Andaj, gjykata duke vendosur komfor nenit, 7,8,9,10,17,21,38,40,42,48,49,69,70,79 dhe 185 par.1, nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe nenet 359, 360, 361, 365, 366, 450, 463 të KPPRK-së, të pandehurve i shqipton:

DËNIM ME KUSHT
Ashtu që:

1. Të pandehurit **S K,** Gjykata iu përcakton, dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajsh,** i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në afatin ligjor prej **1 (një) viti**, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

2. Të pandehurit **M K,** Gjykata iu përcakton, dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajsh,** i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në afatin ligjor prej **1 (një) viti**, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

3.Gjykata duke u bazuar në nenin 79 par.1 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar dy të pandehurve u ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga dt.21.12.2019, deri me dt.31.12.2019, sipas Aktvendimit të kësaj Gjykate me PP nr.148/19 i dt.23.12.2019.

4. Të pandehurit obligohen **secili veç e veç**, në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës ti paguajnë: për ekspertizën mjeko ligjore shumen prej **20 (njëzet) euro,** paushallin gjyqësor në shumë prej **20 (njëzet) euro**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30 € (tridhjetë) euro,** në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

5. Te dëmtuarit **F (O) K** dhe **M (M) D** qe te dy nga fsh. D K. Istogut, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj Gjykate ka ngritë aktakuzën me PP/II/nr.3114/19, me dt. 27.12.2019, ndaj të pandehurve S dhe M K qe të dy nga R, Republika e Malit te Zi , duke i akuzuar si bashkëkryerës për vepër penale, "lëndim i lehtë trupor" nga neni 185 par.1, nënpar.1.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 31.12.2019, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Ersan Qavolli dhe të pandehurve S e M K me mbrojtësit e tyre av. Zeqir Bujupaj dhe av. Pranvera Ukaj, nga Istogu, te caktuar sipas detyrës zyrtare.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit Gjykata kërkoj nga dy të pandehurit të deklarohen lidhur me fajësinë apo pa fajësinë e tyre.

I pandehuri S K, pas konsultimit me mbrojtësin e tij deklaroj se e pranoj fajësinë për veprën penale me te cilën akuzohem, sipas pikës se kësaj aktakuzë, me vjen keq për rastin qe me ka ndodhur, jam penduar, duke shtuar se nuk kam ardhur në territorin e R se Kosovës konkretisht në f.sh. Dobrushë me qellim qe askënd te mos e lëndoj apo qe ti shkaktoj lëndime te lehta ose te renda dikujt, kryesisht kam ardhur për arsyet për një marrëveshje, ndërsa kam mbrojtur nderin dhe integritetin tim ne mënyrë te lejuar ligjor, unë aty nuk kam shkuar qe te bej probleme, por te merrem vesh për një çështje familjare, mirëpo ndërkohë jam nxitur nga pala e dëmtuar qe ti ndërmarr këto veprime te cilat as vet nuk i kam dashur.

Mbrojtësi i te pandehurit S K av.Zeqir Bujupaj deklaroj se pajtohem me pranimin e fajësisë te bere nga ana e klientit tim, i cili pranim është i vullnetshëm dhe me një arsyetim te mjaftueshëm, dhe i njëjti ka qene i nxitur nga ana e te dëmtuarve , i propozoj gjykatës qe ketë pranim fajësisë te aprovoj dhe te njëjtin te marr si rrethanë lehtësuese tek matje e dënimit, po ashtu si rrethanë lehtësuese te merret edhe fakti s e te njëjtit kanë qene te nxitur nga ana e te dëmtuarve .

I pandehuri M K, pas konsultimit me mbrojtësen e tij deklaroj, se e pranoj fajësinë për veprën penale me te cilën akuzohem, me vjen keq për rastin qe me ka ndodhur, jam penduar, është hera e parë qe bije ndesh me ligjin, ju premtoj se ne te ardhmen nuk do te bije ne kundërshtim me ligjin, unë dhe babai im kemi qene te nxitur nga te dëmtuarit.

Mbrojtësja e te pandehurit M K av. Prenvera Ukaj deklaronj, se pajtohem me pranimin e fajësisë te bere nga ana e klientit tim, i cili pranim i fajësisë eshë bere ne mënyre vullnetare dhe ate pas konsultimit me mua si mbrojtëse, kërkoji qe pranimi i fajësisë te merret si rrethana lehtësuese tek matja e dënimit, e po ashtu si rrethanë lehtësuese te merret edhe fakti se i njëjti është hera e pare qe bije ndesh me ligjin dhe eshë penduar për veprën e kryer duke premtuar se ne te ardhmen nuk do te bije ndesh me ligjin , si rrethanë tjetër lehtësuese te merret edhe mënyra e kryerjes se veprës penale , pasi qe kanë qene te nxitur nga pala e dëmtuar dhe ka qene diçka e atëçastshme.

Pas deklarimit te pandehurve dhe mbrojtësve te tyre, Gjykata kërkon mendimin e prokurorit te shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shteti deklaroj, se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarve, pasi qe i njëjti u be pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësit e tyre po ashtu ky pranim i fajësisë ka mbështetje edhe ne provat qe gjenden ne shkresa te lendes, dhe propozoj gjykatës qe me rastin e vendimit mbi dënim pranimin e fajësisë te merr si rrethanë lehtësuese.

Pas deklarimit të te pandehurve dhe mbrojtësve të tyre si dhe pas dëgjimin te mendimit të Prokurorit të Shtetit, Gjykata konstatoj se të pandehurit pranojnë fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, të pandehurit janë të vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimit te fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 te KPRK-së janë përmbushur, andaj Gjykata me aktvendim në procesverbal aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e dy të pandehurve.

Duke pas parasysh se Gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1,1.2,1.3 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPRK-së gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me pranimin e fajësisë nga ana e dy të pandehurve si dhe nga shkresat e lendes që përmban aktakuza Gjykata ka ardhë deri tek vërtetimi i gjendjes faktike se të pandehurit S dhe M K, me dtatë.21.12.2019, rreth orës 14,2o, ne fsh. D K. Istogut, me dashje dhe ne bashkëveprim u shkaktojnë lëndim te lehta trupore të dëmtuarve F K dhe M D nga fsh. D K. Istogut, ne atë mënyrë që të pandehurit kishin ardhur nga Republika e Malit te Zi për te biseduar rreth një çështje familjare (ku vajza e të pandehurit S kishte qenë e martuar me djalin e te dëmtuarit F dhe e njëjta kishte marrë beben 9 muajsh dhe ishte larguar ne Malin e Zi) dhe sapo të pandehurit arrijnë ne oborrin e te dëmtuarit F menjëherë fillon një fjalosje mes tyre, e më pas të dy te pandehurit godasin të dëmtuarit F dhe M, duke ju shkaktuar lëndim te lehta trupore të përshkruara si ne raportin mjekësorë të dt. 21.12.2019 e ku ndërhyjnë dëshmitaret dhe i ndajnë .

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te këtij aktgjykimi, ku pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurve S dhe M K qëndroje të gjitha elementet e veprës penale, lëndim i lehte trupor" nga neni 185 par1, nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se tek të pandehurit ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryejnë në mënyrë e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që të pandehurit kanë qenë të vetëdijshëm për veprën e kryera dhe i kanë dëshiruar kryerjen e tyre.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim te nenit 69,70 të KPRK-së.

Kështu si rrethanë lehtësuese për dy të pandehurit, gjykata vlerësoi faktin se të njëjtit kanë treguar sjellje korrekte në gjykatë, duke pranuar fajësinë për veprën që e kanë kryer, kanë shpreh keqardhje për rastin që ju ka ndodhur, është hera e parë qe kanë renë ndesh me ligjin, duke premtuar se në të ardhmen nuk do bijën ndesh me ligjin, po ashtu edhe faktin se të pandehurit kanë qenë të nxitur nga të dëmtuarit qe ta kryejnë veprën penale. Rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimet e shqiptuar ndaj dy të pandehurve janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale te tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por

ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 te KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale, dhe paushallin gjyqësor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensim të viktimave të krimit është marrë, komfor nenit 39 par.3 nën par 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Gjykata e ka udhëzuar të dëmtuarën në kontest të rregullt juridiko-civil, në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi për llogaritjen e paraburgimit është marrë në kuptim të nenit 79 par.1 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA ISTOG
DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL
P.nr.356/19 më datë 06.01.2020.

Sekretarja Juridike **Gjyqtari Gjykues**

Hale Ahmetaj **Arben Mustafaj**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.